

(Vlerat janë paraqitur në lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

Çaushi SHPK është krijuar më 25/04/1995 dhe është rregjistruar me vendim gjykate dt 25/04/1995. Statusi juridik është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Selia e entitetit ndodhet në L. 6, Rruga Mujo Ulqinaku, Durrës. Objekti i veprimtarisë është Ndërtim.

Veprimtaria e entitetit rregullohet me:

Statut

- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët Shoqëritë Tregtare”,
- Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, ndryshuar me Ligjin Nr. 9477, datë 09.02.2006,
- Legjislacioni Fiskal,
- Akte të tjera ligjore e nënligjore të shtetit Shqiptar.

Drejtimi realizohet nga:

- Xhevahir Çaushi

2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste menaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur.

(Vlerat janë paraqitur në lekë)

Menaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar mëposhtë:

2.6 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatoreve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e nje ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

Krahasueshmeria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësim në standard apo një ndryshim në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i nje numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.



Çaushi SHPK

Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë paraqitur në lekë)

Te drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhe të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si mëposhtë:

Kursi i këmbimit	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
EUR/LEK	121,77	123,42
USD/LEK	108,64	107,82

3.2 Instrumentat Financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet mëposhtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet mëposhtë:

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare


Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në para me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose me pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.



(Vlerat janë paraqitur në lekë)

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për tu paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rendësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.


3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjelle inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën me të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.



Çausi SHPK

Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë paraqitur në lekë)

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen ne "Ndërtim në proces" dhe transferohen ne kategorinë përkatëse të aktivitetit kur perfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si mëposhtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e amortizimit
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera aktiveve afatgjata	Vlera e mbetur	20%
Pajisje për zyrën	Vlera e mbetur	20%
Autovetura	Vlera e mbetur	20%

Çrregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çrregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës. Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta.



(Vlerat janë paraqitur në lekë)

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare rregjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me format e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin e pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyre njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.



(Vlerat janë paraqitur në lekë)

3.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete Monetare

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Arkë	6.090.636	6.102.636
Bankë	6.818	6.902
	6.097.454	6.109.538

Ndarja e mjeteve monetare në arkë dhe në bankë sipas monedhës detajohet si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Mjete monetare në arkë	6.090.636	6.102.636
BKT Lekë	669	669
BKT Euro	6.149	6.233
	6.097.454	6.109.538

5. Të arkëtueshme ndaj klientëve

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Klientë për mallra produkte dhe shërbime	11.204.315	11.204.315
	11.204.315	11.204.315



Çaushi SHPK**Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**

(Vlerat janë paraqitur në lekë)

6. Të tjera të arkëtueshme

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Tatimi mbi fitimin	135.550	135.550
Tvsh	327.882	325.882
Hua të tjera	12.704.770	12.704.770
	13.168.202	13.166.202

7. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Materiale të tjera	273.260	273.260
Inventar i imët	5.800	5.800
	279.060	279.060



Çaushi SHPK
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë paraqitur në lekë)

8. Aktivet Afatgjata Materiale

Gjendja e aktiveve afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

Pershkrimi	Toka	Ndertime	Instalime, makineri e pajisje	Mjete transporti	Paisje Zyre e informatike	AAGJM te tjera mobilje e orendi	Totali
Kosto e AAM 31 Dhjetor 2018	-		2,452,369	5,528,136	482,018	-	8,462,523
Amortizimi i akumuluar	-		(1,898,807)	(3,843,465)	(261,357)	-	(6,003,629)
Aktivt Afatgjata Materiale me 31 dhjetor 2018	-	-	553,562	1,684,671	220,661	-	2,458,894
Shtesa te AAM		-					-
Pakesime te AAM		-					-
Amortizimi i vitit							-
Rimarrje e amortizimit							-
Aktivt afatgjata materiale me 31 dhjetor 2019	-	-	553,562	1,684,671	220,661	-	2,458,894



Çaushi SHPK

Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë paraqitur në lekë)

9. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të pagueshme ndaj furnitorëve	7.085.579	7.085.579
	7.085.579	7.085.579

10. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Paga e shpërblime	2.406.148	1.604.361
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	596.021	221.700
	3.002.169	1.826.061

11. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga shërbimet	-	248.790
	-	248.790

12. Të ardhura të tjera

Pershkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e AAGJM	-	700.000
	-	700.000

13. Të ardhura nga interesat

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga interesat bankare	-	20.787
	-	20.787

14. Shpenzime për mallra, lëndë të parë, materiale

Përshkrimi	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Blerje materiale të para	-	213.111
Ndryshim gjendje materiale të para	-	(36.750)
	-	176.361



Çaushi SHPK

Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë paraqitur në lekë)

15. Kosto e punës

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Paga dhe shpërblime	902.912	1.823.879
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	150.786	304.593
	1.053.698	2.128.472

16. Shpenzime Amortizimi e Konsumi

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime amortizimi	-	420.428
	-	420.428

17. Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të tjera	-	127.855
Personel nga jashtë ndërmarjes	10.000	10.000
Shpenz për koncesione, patenta, licensa dhe të ngjashme	-	49.750
Shërbime bankare	-	8.649
Tatime, taksa të tjera	-	6.500
Gjoha dhe dëmshpërblime	122.409	15.849
Mirëmbajtje dhe riparime	-	440.718
Vlera kontabël e AQ të shitura	-	625.000
Shpenzime telekomunikacioni	-	112.202
	132.409	1.396.523

18. Shpenzime interesi dhe të tjera

Pershkrimi	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime nga interesat bankare	(83)	11.185
	(83)	11.185



Çaushi SHPK

Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë paraqitur në lekë)

19. Rezultati i vitit


Përshkrimi	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	(1.186.190)	(3.163.392)
Shpenzime të pazbritshme:		
Gjoha dhe dëmshpërblime	122.409	15.849
Të tjera	-	-
Fitimi i tatueshëm	(1.063.781)	(3.147.543)
Tatim fitimi i vitit		
Rezultati i vitit	(1.186.190)	(3.163.392)

Pasqyrat Financiare janë përgatitur nga Finstudio Er&Led dhe janë aprovuar nga Administratori i Shoqërisë.

Data: 29/03/2020

Mimoza HASANAJ

FINSTUDIO ER&LED SHPK



Xhevahir ÇAUSHI

ADMINISTRATORI

